



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË
MINISTRISË SË INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË PËR
VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Vlera e pasurisë kapitale e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar për 2,828,978€ si rezultat i kategorizimit të gabuar të pasurive, në anën tjetër kemi mbivlerësim për 81,211€ si rezultat i mos bartjes së projektit pas përfundimit tek komuna përkatëse.
- B2 MINT gjatë vitit 2022 kishte realizuar pagesa në vlerë prej 127,298€ për 25 punonjës (të angazhuar me Marrëveshjen e Brukselit) të cilët nuk evidentohen për vijueshmërinë në punë dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në MINT.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MINT kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Shpenzimet e realizuara nga kategoria mallra dhe shërbime për rezervat shtetërore nuk janë audituar për shkak të klasifikimit të tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

UD Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, UD Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një

opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fushat që kërkojnë veprime të menjëhershme për shkak të ndikimit të tyre në PFV janë menaxhimi dhe mirëmbajtja e regjistrave të pasurive, si dhe kompensimi i punonjësve. Po ashtu, veprime duhet të ndërmerren edhe tek çështjet tjera të identifikuara në kategoritë përkatëse.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, dhe pesë (5) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Nënvlërim/ mbivlerësim i pasurisë kapitale

Gjetja

Neni 6.1 i Rregullores MF-NR. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton që: Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Për më tepër, neni 22 i kësaj rregullore përcakton metodën e zhvlerësimit të pasurive, normën si dhe llogaritjen bazuar në natyrën e pasurisë. Tutje, neni 12 i kësaj rregullore përcakton mënyrën e regjistrimit, kategorizimit dhe kalimit të pronësisë me rastin e blerjes apo ndërtimit të pasurisë përmes bashkëfinancimit.

Vlera e prezantuar e pasurisë në PFV ishte nënvlërsuar për 2,828,978€ si rezultat i kategorizimit jo të drejtë të klasave të pasurive si dhe mos bartjes së pronësisë së pasurive pas pranimit të tyre tek komuna përkatëse, në anën tjetër regjistrat ishin mbivlerësuar 81,211€.

Çështjet që kanë ndikuar këtë gjendje janë shpalosur si në vijim:

- Shtatë (7) pagesa për projektin "Ndërtimi i Qendrës së Panairëve në Bërnice" ishte kategorizuar si "Kapitale tjera" duke u zhvlerësuar për 10 vite, me vlerë aktuale zero, ndërsa sipas rregullores do të duhej të ishte kategorizuar "Ndërtesë jo rezidenciale" me jetëgjatësi 40 vite. Vlera neto në libra (VNL) sipas kalkulimeve do të duhej të ishte 2,111,916€, me ç'rast regjistrat ishin nënvlërsuar për këtë shumë;
- Tre (3) pagesa për projektin "Ndërtimi i Laboratorit të Industrisë Kimike" ishte kategorizuar si "Kapitale tjera" duke u zhvlerësuar për 10 vite, me vlerë aktuale zero, ndërsa sipas rregullores do të duhej të ishte kategorizuar "Ndërtesë jo rezidenciale" me jetëgjatësi 40

vite. VNL do të duhej të ishte 715,271€, me ç'rast regjistrat ishin nënvlerësuar për këtë shumë;

- PAGESA në vlerë 11,946€ për projektin "Avancimi i sistemit softuerik të ARBK-së" i regjistruar fillimisht në 2013 në regjistër figuron si investim në vijim duke mos u zhvlerësuar fare. Si rezultat i kësaj regjistri i pasurisë është i mbivlerësuar për 10,751€. Në anën tjetër, pagesa tjetër në vlerë prej 17,919€ për projektin e njëjtë është kategorizuar si softuer por ishte zhvlerësuar për 7 vite. Vlera neto në libra ishte 0. Kjo kishte bërë që regjistri të jetë i nënvlerësuar për 1,792€; si dhe
- PAGESA lidhur me projektin "Rregullimi i Infrastrukturës për Zonën Ekonomike Parku Teknologjik Shtime" në vlerë prej 70,460€ ishte ende i regjistruar si investim në vijim edhe pse pranimi teknik i projektit ishte bërë më 31.07.2015. Pasuria ende nuk ishte bartur te komuna përfituese.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i klasifikimit të gabuar të këtyre pasurive me rastin regjistrimit së tyre dhe në vazhdimësi kjo nuk ishte korrigjuar. Këto parregullsi ishin ndikuar edhe nga lëvizjet e shpeshta të zyrtarëve.

Ndikimi

Klasifikimi jo i duhur i pasurive në regjistrat kontabël, ka ndikuar në aplikimin e pasaktë të normave të zhvlerësimit dhe ka shkaktuar nënvlerësim të vlerës së pasurisë në regjistrat kontabël. Në anën tjetër, mbajtja e projekteve të përfunduara në regjistrin e pasurisë si investime në vijim pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. E gjithë kjo ka rezultuar në pasqyrim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV.

Rekomandimi B1

Ministrja duhet të siguroj se aplikohet një analizë e mirëfilltë e regjistrit të pasurive për të siguruar se ato janë kategorizuar drejtë, në mënyrë që saldo e bartur në vitin vijues të ofrojë informata të sakta dhe raportim të drejtë në PFV. Po ashtu, të sigurojë që projektet e bashkëfinancimit për të cilat janë bërë pranimet teknike nga pala përfituese, të bëj bartjen e pronësisë përmes procedurave formale dhe në të njëjtën kohë të i largoj nga regjistrat e pasurisë së ministrisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Kompensim i punonjësve pa vijueshmëri në punë

Gjetja

Neni 8 i Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve", përcakton se "Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik".

Me vendimin nr. 06/39 te datës 22.07.2015, Qeveria e Kosovës ka aprovuar

konkluzionet e dakorduar të Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për integrimin e personelit nga ish e ashtuquajtura "Mbrojta Civile". Përmes këtij vendimi, MTI kishte angazhuar 25 punonjës të komunitetit serb me qëllim të integritit të tyre në sistemin e Republikës së Kosovës. Këta punonjës nuk kishin punuar asnjëherë për MTI që nga viti 2016 kur edhe janë nënshkruar aktemërimet a tyre. Rrjedhimisht, sipas konfirmimeve nga zyrtarët relevant, për të njejtit nuk kishte dëshmi të vijueshmërisë në punë. Shpenzimi për vitin 2022 për pagat e të punësuarve për këtë kategori ishte 127,298€.

Kjo dukuri po vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse është raportuar në vazhdimësi nga Raportet tona të auditimit. Ministria ende nuk ka arritur të ndërmarrë masa konkrete në sistemimin, angazhimin dhe monitorimin e kësaj kategorie të të punësuarve.

Ndikimi

Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmive për vijueshmëri në punë dhe në mungesë të angazhimit për kryerjen e detyrave zyrtare, konsiderohen si pagesa të parregullta dhe dëmtojnë buxhetin e ministrisë

Rekomandimi B2

Ministrja duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2022 ishte në vlerë 12,274,960€, prej tyre ishin shpenzuar 11,586,857€. Ato kanë të bëjnë kryesisht blerje për rezerva shtetërore si dhe shpenzimet për shërbime kontraktuese, për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, dreka zyrtare, shpenzimet e telefonit si dhe shpenzime tjera operative.

Çështja A1 - Pranimi i shërbimeve para nënshkrimit të kontratës

Gjetja

Sipas nenit II të kontratës për Kalibrimin e instrumenteve matëse e nënshkruar në mes MINT dhe Institutit të Metrologjisë së Çekisë (IMÇ) me datën 16.12.2022, pas realizimit të kalibrimit të instrumenteve matëse IMÇ lëshon certifikatën e kalibrimit. Ndërsa, neni VII Forca e kontratës dhe përfundimi, pika 1 Ky dokument parashton të gjithë marrëveshjen dhe mirëkuptimin ndërmjet palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje dhe bashkon të gjitha diskutimet e mëparshme ndërmjet tyre.

Shërbimi i kalibrimit të instrumenteve matëse të Agjensia e Metrologjisë së Kosovës (AMK) - MINT, ishte pranuar para nënshkrimit të kontratës. Ky shërbim ishte bazuar në një marrëveshje mirëkuptimi në mes të Institutit të Metrologjisë së Çekisë (IMÇ) dhe AMK- MINT të datës 17.05.2022. Certifikatat e kalibrimit ishin lëshuar nga data 02.11.2022 deri me datën 13.12.2022, përderisa pagesat ishin kryer me 22.12.2022 (shpenzimet ishin 17,816€).

Kjo kishte ndodhur për shkak se nuk kishte kordinim të duhur të zyrtarëve lidhur me pranim të shërbimit para nënshkrimit të kontratës.

Ndikimi

Pranimi i shërbimeve para nënshkrimit të kontratës mund të ndikoj mbarëvajtjen e procesit të kalibrimit si dhe marrjen e përgjegjësisë nga të dyja palët në pajtim me kontratën.

Rekomandimi A1

Ministrja duhet të sigurojë një koordinim në mes të zyrtarëve përgjegjës për të siguruar se para çdo aktiviteti zbatohen procedurat e duhura drejt menaxhimit të aktiviteteve bazuar në të drejtat dhe përgjegjësitë kontraktuale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B3 - Ndarje e tenderëve për punë të njëjta**Gjetja**

Sipas nenin 5.3 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, AK për të planifikuar aktivitetet e prokurimit duhet të mbledhë kërkesat, kur është e mundshme (të njëjta ose të ndërlidhura), për të fituar vlerën për paranë dhe për të reduktuar kostot e prokurimit.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se në tetë (8) procedura të prokurimit ⁵ në vlerë prej 13,717€, ministria kishte aplikuar ndarje të tenderëve për punë të natyrave të njëjta duke përdorur procedurën e kuotimit të çmimit, si dhe vlerën minimale.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos planifikimit të mirë të nevojave nga ana e njësive kërkuese.

Ndikimi

Mos aplikimi i një procedure të vetme të prokurimit për kërkesat e njëjta/ngjashme mund të rezultojë me një kosto më të lartë të shpenzimeve sesa çmimet e konkurrencës.

Rekomandimi B3

Ministrja duhet të sigurojë që planifikimi i prokurimit bëhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet menaxherit të prokurimit me njësitë kërkuese për të diskutuar kërkesat e tyre me kohë për prokurim, në mënyrë që të ketë një planifikim të drejtë dhe të saktë, duke evituar çfarëdo ndarje të aktiviteteve të njëjta të prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,580,495€, prej tyre në 2022 ishin shpenzuar 584,466€. Ato kanë të bëjnë me realizimin e projekteve kapitale, si: ndërtimi i zonave ekonomike, ndërtimi i parqeve të industriale, renovimi i hapësirave të brendshme, inkubatorët e biznesit.

Çështja B4 - Vonesat në realizimin e punimeve**Gjetja**

Në kontratat e nënshkuara ndërmjet MINT dhe operatorëve ekonomik për realizimin e projekteve kapitale përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve sipas kontratës.

Ne kemi identifikuar tre (3) raste ku punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik, siç parashihej me kontratë:

- Ndërtimi i infrastrukturës në Parkun Industrial në Budrikë - Viti, vlera e kontratës 1,774,712€ e datës 09.11.2018 duhej të përfundonte

brenda 250 ditë pune, ndërsa deri në fund të vitit 2022 ishin përfunduar vetëm 85 % e punimeve;

- Ndërtimi i Inkubatorit të Biznesit në Malishevë, vlera e kontratës 271,172€ e datës 08.04.2019 duhej të përfundonte brenda 100 ditë pune, ndërsa punimet ishin përfunduar vetëm 88,25% deri në fund vit;
- Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial në Lumadh – Vushtri vlera e kontratës 1,286,691€ e datës 25.03.2019 duhej të përfundonte pas 200 ditë pune, përkatësisht 230 ditë pune duke e përfshirë edhe aneks kontratën. Për më tepër, vonesa kishte edhe në pranimin teknik të Parkut Industrial në Vushtri. Kërkesa për pranim teknik nga ana e operatorit ekonomik ishte bërë me 26.11.2021, ndërsa komisioni për pranim teknik ishte themeluar me 3 muaj vonesë, përkatësisht me 10.03.2022. Shpenzimet totale për këtë projekt ishin në vlerë 1,414,915€.

Arsyeja e vonesave në realizimin e këtyre projekteve ishte paraqitja e nevojës për ndryshime dhe punë shtesë si dhe rritjes së çmimeve të materialit ndërtimor.

Ndikimi

Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që MINT të mos arrijë objektivat e përcaktuara dhe njëherësh mund të shkaktoj vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

Rekomandimi B4

Ministria duhet të sigurojë se para inicimit të procedurave tenderuese kryhen analiza të detajuara për projektet përkatëse në mënyrë që realizimi i tyre të mos pësoj ndryshime prej planit. Po ashtu, ministria duhet të sigurojë përmes stafit përkatës një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të papërfunduara. Më tutje të ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që punimet të realizohen sipas planit dinamik të kontraktuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 13,013,138€, pasurive jokapitale është 100,671€, si dhe e stoqeve 1,607€.

Çështja B5 - Mos-harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë

Gjetja

Neni 19.4 i Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare, përcakton se çdo fund vit duhet të behet inventarizimi, nga komisioni për inventarizim i cili është përgjegjës për: Inventarizimin e të gjithë pasurisë jo financiare që janë në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore, verifikimi fizik dhe cilësor të gjendjes së pasurisë jo financiare, krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare,

dhe hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare.

Në MINT është bërë inventarizimi i pasurisë për vitin 2022, komisioni ka përpiluar një raport gjithëpërfshirës mirëpo nuk ka bërë harmonizimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe se raportimi i pasurive në PVF ishte bërë sipas regjistrave kontabël. Komisioni i inventarizimit ishte fokusuar vetëm në pasuritë që janë në objektin kryesor të MINT.

Për më tepër, komisioni, nuk kishte arritur që të identifikojë në saktësi pasurinë e ish Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në vlerë prej 20,624€. Kjo pasuri ishte prezantuar në PFV vetëm si total i pasurisë nën 1,000€ nga ish Ministria e Inovacionit dhe për të njëjten nuk ishte aplikuar zhvlersimi pasiqë nuk figuronin në regjistrat e MINT-it.

Gjithashtu vlen të theksohet, që informatat e vendosura në SIMFK me rastin e regjistrimit të pasurisë ndër vite, nuk posedonin mjaftueshëm detaje për të konfirmuar se për cilën pasuri bëhet fjalë.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive nga komisionet e inventarizimit të pasurive dhe ndërrimit të shpeshtë të zyrtarit të pasurisë.

Ndikimi

Mungesa e inventarizimit të pasurive pamundëson krahasimin e rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive, prandaj vlera e pasurive në PFV mund të mos jetë e saktë.

Rekomandimi B5

Ministrja duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë ka informata të plota për të gjithë pasuritë në përdorim dhe në pronësi të ministries, si dhe pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundoj para përgatitjes së PFV për vitin 2023.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2.4 Të arkëtueshmet

Pasqyra e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2022 ishte 360,137€ përderisa në vitin paraprak ishin 273,943€. Llogaritë e arkëtueshme përbëhen nga faturimet e qirasë në Parkun e Biznesit Drenas (PBD) si dhe shërbimeve të ofruara nga Metrologjia.

Çështja A2 - Mungesa e veprimeve konkrete nga Ministria në arkëtimin e të hyrave nga qiraja në Parkun e Biznesit

Gjetja

MINT ka dy lloje të kontratave për dhënie të parcelave me qira në Parkun e Biznesit në Drenas varësisht nga periudha. Për kontratat para vitit 2013 neni 3 përcakton "kushtet e pagesës së qirasë" - Qiramarrësi është i obliguar që prej datës 1 deri më 5 të kryej pagesën e qirasë të muajit vijues. Në rast të vonësës së pagesës së qirasë, qiramarrësi do të ndëshkohet konform kamatave bankare të cilat janë në fuqi. Ndërsa, për kontratat pas vitit 2013 neni 2 përcakton "kushtet e pagesës së qirasë" - Qiramarrësi është i obliguar t'i paguaj qiranë qiramarrësit çdo 6 muaj, më së largu deri më datën 15 të muajit vijues. Në rast të vonësës së pagesës së qirasë, qiramarrësi do të ndëshkohet të paguaj interesin 5% të shumës së pagesës së qirasë. Dispozitat e kontratës përcaktojnë se e drejta e shkëputjes së njëanshme të kontratës bëhet në veçanti me rastin e shkeljes së detyrimeve kontraktuese nga ana e qiramarrësit të parapara me ligjet në fuqi.

Në tre (3) raste shfrytëzuesit e pronave nuk i kishin kryer obligimet ndaj ministries për vitin 2022 në vlerë prej 22,993€, përderisa në dy (2) raste (njëri nga tre rastet më sipër si dhe një rast tjetër) kishte mos pagesë të qirasë edhe nga vitet paraprake, në vlerë prej 54,727€. Të gjitha rastet e testuara janë fatura të cilat kanë tejkaluar afatin e përcaktuar me kontratë, dhe se MINT në asnjërin rast nuk kishte ndërmarrë masa për shkëputjen e kontratave.

Rritja e llogarive të arkëtueshme vjen si rezultat i mos zbatimit të kornizës ligjore dhe përpjekjeve të pa mjaftueshme të Ministrisë që operatorët të paguajnë qiratë për hapësirat që shfrytëzojnë në Parkun e Biznesit në Drenas.

Ndikimi

Mungesa e veprimeve konkrete për arkëtimin e të hyrave nga qiraja rrezikon me humbje financiare për Ministrinë dhe mund të shkaktojë precedent duke ndikuar negativisht në subjektet tjera që ti paguajnë obligimet e tyre me kohë, ndërsa vjetërsia e tyre e vështirëson inkasimin. Po ashtu, ndikon zbatimin e marrëveshjes me komunat përkatëse ku është potencuar që 70% e mjeteve nga qiraja e parqeve të biznesit derdhet në buxhetin e asaj komune.

Rekomandimi A2

Ministrja duhet të siguroj se shfrytëzohen të gjithë mekanizmat ligjorë në inkasimin e të arkëtueshmeve dhe në rast të mosrespektimit të kushteve të kontratës nga operatorët ekonomik, të shqyrtoj mundësinë e shkëputjes së kontratave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^a	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	16,588,333	32,253,828	26,215,968	14,012,257	7,065,092
Grante Qeveritare – Buxheti	11,910,115	27,560,610	24,000,365	13,685,355	5,840,642
Financimi përmes huamarrjes	3,078,218	3,078,218	2,215,603	326,901	525,186
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	1,600,000	1,600,000	0	0	0
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	699,264
Donacionet e jashtme	0	15,000	0	0	0

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 15,665,495€. Ky ndryshim është rezultat i ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndarjes së fondeve të donatorëve si dhe ndarjes së buxhetit shtesë tek kategoria e mallra dhe shërbimeve për blerjen e rezervave shtetërore.

Në vitin 2022 MINT kishte shpenzuar 26,215,968€ apo rreth 81% të buxhetit me një performancë më të mirë në krahasim me vitin 2021 ku realizimi i buxhetit ishte në nivel 51%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	16,588,333	32,253,828	26,215,968	14,012,257	7,065,092
Pagat dhe mëditjet	2,049,811	2,049,811	1,779,595	1,906,700	1,858,722
Mallrat dhe shërbimet	2,540,301	12,274,960	11,586,857	1,530,090	1,805,730
Komunalitë	158,280	88,281	42,437	38,919	41,785
Subvencionet dhe transferet	7,369,941	14,260,281	12,222,613	9,764,566	1,279,224
Investimet Kapitale	4,470,000	3,580,495	584,466	771,982	2,079,631

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar kishte mbetur i pandryshuar dhe i njëjti ishte shpenzuar në nivel rreth 87%. Kjo ulje e shpenzimeve ishte ndikuar nga një numër i madh i vendimeve për pushimet pa pagesë të personelit. Po ashtu, krahasuar me vitin paraprak kemi ulje të shpenzimeve prej 7%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 9,734,659€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimit të Qeverisë për rritjen e buxhetit për blerjen e rezervave shtetërore (Masa 3.8) si dhe kursimeve buxhetore;
- Buxheti final për shpenzime komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 79,999€ sipas Vendimeve të Qeverisë, si dhe transfereve dhe rialokimeve buxhetore;
- Buxheti final për investime kapitale, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 889,505€, përkundër zvoglimit buxheti final ishte shpenzuar vetëm rreth 16%. Nga dhjetë projektet e planifikuara vetëm katër kishin progres financiar. Ky rezultat ishte ndikuar nga vonesat në fillimin e procedurave të prokurimit, procedurat ankimore në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), si dhe vonesat në miratimin e Ligjit për inspektime që kishte ndikuar realizimin e projektit për krijimin e sistemit të inspektoratit;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 6,890,340€. Ndryshimet kishin ndodhur si rezultat i Vendimeve të Qeverisë lidhur me pakon e rimëkëmbjes.


Shpenzimet sa i përket pakos së rimëkëmbjes ekonomike ishin 6,067,378€ si në vijim:

- Masa 2.4 Mbështetja e Eksportit, të dedikuara për Projektin e Konkureshmërisë dhe Gadishmërisë për Eksporte, Banka Botërore (CERP) fillimisht ishin alokuar mjete në vlerë prej 7,149,864€, mirëpo gjatë vitit 6,359,840€ ishin deklaruar si kursim pasi nuk kanë mundur të realizohen. Buxheti final ishte 790,024€, nga të cilat ishin shpenzuar 602,370€ për qëllim të subvencionimit të entiteteve jo publike.

- Masa 2.1 Subvencionimi i kredive investive, ishin alokuar 6,000,000€ në programin Agjensia për Investime dhe përkrahjen e Ndërrmarjeve në Kosovë (KIESA) nga të cilat të shpenzuara ishin 5,465,006€.

Totali i shpenzimeve për "Programin e Ringjalljes Ekonomike" nga kodi i projektit (00098) ishin 15,925,670€, prej tyre në mallra dhe shërbime janë shpenzuar 9,858,293€ për masën 3.8 si dhe 6,067,378€ subvencione dhe transfere për masat 2.1 dhe 2.4.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga MINT në 2022 ishin në vlerë prej 2,609,786€. Ato kanë të bëjnë me regjistrimin e pengut, pronësisë industriale, të hyrat nga licenca për shërbime profesionale, licenca për importimin e naftës, licencat për importimin e duhanit, të hyrat nga qiraja dhe të hyrat tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	2,649,067	2,649,067	2,609,786	2,483,017	1,912,701
Të hyrat jo tatimore	2,649,067	2,649,067	2,469,937	2,472,796	1,904,553
Të hyrat tjera	0	0	139,849	10,221	8,148

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të MINT ka rezultuar në shtatë (7) rekomandime. MINT kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, dy (2) rekomandime janë zbatuar dhe pesë (5) rekomandime nuk janë adresuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministrja duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.	Gjatë vitit aktual ne nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar

2.	Baza për opinion	Ministrja duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë. Po ashtu të sigurojë se projektet e financuara për komuna për të cilat janë bërë pranimet teknike nga komuna e të cilat i kanë nën administrim këto pasuri, përmes procedurave formale të bëj bartjen e pronësisë dhe në të njëjtën kohë të largoj nga regjistrat e pasurisë së ministrisë.	Edhe gjatë 2022 kemi identifikuar raste të njëjta	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Pagat dhe mëditjet	Ministrja duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprime as këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja në bashkëpunim me MPB-në të gjejnë një zgjidhje sa më të shpejtë për lidhjen e kontratës me njërin nga operatorët ekonomik të telekomunikimit në mënyrë që më tutje të realizohen shpenzimet e rregullta bazuar në një kontratë valide për këto lloje të shërbimeve..	Në fillim të vitit 2022 ishte nënshkruar kontrata me PTK dhe ishte implementuar rekomandimi	I zbatuar
5.	Investimet kapitale	Ministrja duhet të sigurojë se para inicimit të procedurave tenderuese kryhen analiza të detajuara për projektet përkatëse në mënyrë që realizimi i tyre të mos pësojë ndryshime prej planit. Po ashtu, ministja duhet të sigurojë përmes stafit përkatës një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të papërfunduara. Më tutje të ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që punimet të realizohen sipas planit dinamik të kontraktuar.	Ne gjatë vitit 2022 kemi identifikuar parregullsi të njëjta dhe vonesa në realizimin e punimeve.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Çështjet e përbashkëta	Ministrja duhet të sigurojë që planifikimi i prokurimit bëhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet menaxherit të prokurimit me njësitë kërkuese për të diskutuar kërkesat e tyre me kohë për prokurim, në mënyrë që të ketë një planifikim të drejtë dhe të saktë, duke evituar çfarëdo ndarje të aktivitetëve të njëjta të prokurimit.	Ne gjatë vitit 2022 kemi identifikuar raste të reja të ndarjes së tenderëve në vlera të vogla.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Pasuritë	Ministrja duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e	Edhe në vitin 2022 janë identifikuar pa rregullësi të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin

		mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundoj para përgatitjes së PFV për vitin 2022.		
--	--	--	--	--

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Neslihane Mati, Udhëheqëse e ekipit



Mimoza Morina, Anëtare e ekipit



Mirlinda Beqiri, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Nënvlerësim/ mbivlerësim i pasurisë kapitale	Sa i përket çështjes se regjistrimit të pasurisë jo financiare, zyrtarja e pasurisë për projektet që kanë përfunduar në fund të vitit kalendarik i ka regjistruar si pasuri jo financiare konform rregullores së MF-NR. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, dhe kodeve ekonomike që janë të përcaktuara për shpenzimin e kryer dhe të njëjtat ne i kemi pasqyruar në Pasqyrat Vjetore Financiare 2022. Sa i përket projekteve nga vitet e kaluara, ne i kemi klasifikuar në periudhën në të cilën kanë ndodhur dhe të njëjtat kanë vazhduar së prezantuari në çdo raport vjetor (PFV). Në momentin që kemi marr rekomandimin kemi adresojmë shkresë zyrtare për korrigjim të kategorisë ekonomike Thesarit të Kosovës. Për këtë çështje edhe është adresuar shkresa nga Zyra e Financave së MINT e cila edhe u është dhënë zyrtarëve të ZKA-së.	Në të gjeturën B1 është prezantuar kategorizimi i gabuar i pasurisë i cili ka ndikuar në mbivlerësimin e tyre, mos aplikim i zhvlerësimit dhe mos barjte e pasurisë tek komuna përfituese, të cilat kanë rrjedhur nga mostrat e përzgjedhura në procesin e auditimit. Ministria nuk e konteston të gjeturën dhe konfirmon veprimet që kanë ndërmarrë pas pranimit të draft raportit. Të njëjtat nuk ndikojnë gjendjen e paraqitur në raport. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.
Kompensim i punonjësve pa vijueshmëri në punë	Për informimin e juaj MINT ka bërë përpjekje të vazhdueshme për implementimin e rekomandimit edhe në vitet paraprake. MINT disa herë i është drejtuar MPB-së përmes kërkesave zyrtare (shih dokumentet e bashkëngjitura) duke kërkuar një objekt për akomodimin për punë të pjesëtarëve të komunitetit serb sipas Marrëveshjes së Brukselit për shuarjen e të ashtuquajturës Mbrojtja Civile (MC), ku ata do të mund të përcillnin vijueshmërinë e tyre, pasi edhe janë të pajisur me kartela identifikuese. Përkundër	Ministria nuk e konteston përmbajtjen e gjetjes, mirëpo i referohet komunikimeve të periudhave paraprake pa ndonjë rezultat konkret. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.

	<p>kërkesës tonë ne nuk kemi asnjë përgjigje nga institucioni përkatës. Lidhur me këtë çështje, me datën 20.10.2020 kemi adresuar kërkesën edhe në Ministrinë e Pushtetit Lokal për të parë se si kanë vepruar ata. Përgjigjja e tyre ka qenë se i kanë transferuar zyrtarët e tyre në gjitha komunat veriore të Kosovës. Për më tepër shih dokumentet e bashkëngjitura. Përkundër këtyre vështirësive që i cekëm më lartë, MINT do të bëjë përpjekje për implementimin e këtij rekomandimi.</p>	
<p>Ndarje e tenderëve për punë të njëjta</p>	<p>Kërkojmë të modifikohet e gjetura në raportin final për shkak që procedurat e prokurimit kanë qenë subjekt i trajtimit nga institucionet tjera, me poshtë i gjeni arsyet: Procedurat e prokurimit janë realizuar sipas nevojave të domosdoshme nga MINT në periudha të ndryshëm. Për 8 procedurat e identifikuar nga ZKA ku për 6 procedura të prokurimit kanë qenë derivat i kontratave të AQP-së. Nga AQP jemi njoftuar se janë shpenzuar sasisë nëpër kontratat për furnizim me materiale zyrtare dhe materialet e ndryshme. Për këtë arsye, Ministria ka zhvilluar procedurat e prokurimit për të plotësuar nevojat e ministrisë. Për më shumë shih njoftimet e AQP-së të dërguara me e-mal.</p> <p>Ndërsa për 2 procedurat e prokurimit lidhur me servisimin e automjeteve nuk kemi pasur kontratë për arsyen se lënda ka qenë në procedurë të ankimimit në OSHP, dhe gjatë asaj periudhe, Bordi OSHP-së nuk ka qenë funksional dhe janë shkaktuar vonesa dhe si rrjedhojë Ministria është detyruar të zhvillojë procedura të prokurimit për servisimin e automjetet në periudha të ndryshme sipas nevojave.</p>	<p>Në tetë mostrat e testuara ministria kishte bërë ndarjen e tenderëve në vlera minimale. Në tre procedura për Furnizim me thasë dhe vula për të cilat AQP nuk ka kontratë meqenëse janë për furnizime specifike të inspektorëve, tre procedura për servisim të automjeteve bazuar në vendimin e OSHP nr 857/21 të dates 05.01.2022 i jepet e drejtë ministrisë të vazhdoj me procedure konform nevojave të saj, si dhe dy procedura për furnizim me material zyrtar si rezultat i tejkalimit të vlerave të parashikuara me kontratë të AQP. Ministria për këto procedura do të duhej të vlerësonte nevojat dhe kërkesat reale dhe të zhvillonte procedurën e duhur të prokurimit.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</p>

	Për me shumë shih vendimin nga OSHP 857/21 të datës 28.07.2022.	
Pranimi i shërbimeve para nënshkrimit të kontratës	Sa i përket këtij rekomandimi, kjo ka ndodhur për shkak se kompetencat – autorizimit të datës 05.07.2022, që i ka bartur ish zv. sekretari i përgjithshëm Arbër Gegaj, te drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës. Autorizimi i është bashkëngjitur dhe dhënë ZKA-së.	Komenti nuk është relevant me çështjen e paraqitur. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.
Mos-harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë	Duke u bazuar në Rregullores Nr. 02/2013, ZKA ka formuar komisionin për Inventarizimin e pasurive jo kapitale nën 1,000 euro, ku ka vërtetuar saktësinë e pasurisë në përdorim dhe jashtë përdorimit, si dhe ka bërë verifikimin e gjendjes së pasurisë jo financiare në terren, po ashtu ka identifikuar pasurinë e dëmtuar.	Ministria kishte formuar Komisionin e Inventarizimit, mirëpo raporti ishte i mangët dhe nuk ishte bërë harmonizimi i gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurisë. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.
Mungesa e veprimeve konkrete nga Ministria në arkëtimin e të hyrave nga qiraja në Parkun e Biznesit	Ju njoftojmë se sa i përket borxhit ose llogarive të arkëtushme deri me tani, u kemi kërkuar bizneseve që deri më datë 14.04.2023 të kryejnë të gjitha obligimet që kanë ndaj qirasë, për vitet 2020, 2021 dhe 2022. Po ashtu ju njoftojmë se jemi në përgatitje të dokumentacionit për dërgimin e lëndëve në procedurë përmbartimore. Derisa të gjitha obligimet që kanë pasur bizneset deri në vitin 2019, përmes departamentit ligjor të MINT, janë dërguar në Avokaturën Shtetërore për zhvillim të procedurave përmbartimore. Sa i përket borxheve të cekura në raport, aty përfshihen shumat edhe para vitit 2019, e siç ju njoftova me lartë, deri në vitin 2019 të gjitha lëndët janë dërguar në avokaturën shtetërore. Sa i përket shkëputjes së kontratave,	Ministria ka paraqitur hapat e ndërmarrë në vitin 2023 të cilat nuk e ndryshojnë gjendjen e paraqitur në raport. Avokatura Shtetërore ka mandat për mbrojtjen e interesave të Institucioneve Publike por jo për inaksimin e të hyrave. Inkasimi i të hyrave nga parqet e biznesit është nën mandatin e MINT. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.

	<p>ne çdo herë e njoftojmë Bordin Mbikëqyrës të Parkut të Biznesit në Drenas, i cili në bazë të raportit të qirasë ka mundur të marr vendim për shkëputje të ndonjë kontrate apo jo, mirëpo duke pasur parasysh se qiratë inkasohen përmes avokaturës shtetërore, pothuajse bizneset nuk mbesin borxh ndaj qiradhënësit.</p>	
--	--	--




Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet e juaja, për të cilat ju përcjellim edhe komentet.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Znj / Rozeta Hajdari - Ministre



Data: 9 qershor 2023, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹⁰, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të

mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ 1. Servisimi i rregullt për 5 vetura Ford-Ritenderim; 2.Furnizim me blloka dhe fasiklla për nevojat e MINT;3.Furnizim me material zyrtar-Ritenderim; 4.Furnizim me thasë dhe vula të sigurisë për nevojat e Inspektoratit;5. Furnizim me material zyrtar për nevojat e MINT ; 6.Servisim dhe mirembajtja e automjeteve MINT;7.Furnizim me thasë dhe vula të sigurisë dhe shishe të plastikes për nevojat e Inspektoratit; 8. Furnizim me notesa dhe kimika për nevojat e MINT
- ⁶ Rekomandim nga Raporti i Auditimit për vitin 2021
- ⁷ Bëqësi obligime 3551.1.€;Metaj, obligime për vitin 2022, është në vlerë prej 11,561.16€,ndërsa për vitet nga 2021 e tutje, ka obligime ndaj qirasë në vlerë prej 52,902.03 €;Plastika obligime për vitin 2020, për 2 muaj (prill dhe maj), në vlerë prej 1,824.64 €; Venena obligime të mbetura ndaj qirasë ka vlerën prej 7,872.90€.
- ⁸ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹⁰ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.